



Instituti i Kosovës për Drejtësi

Prishtinë, 8 nëntor 2013

Autorët: Betim Musliu dhe Adem Gashi

# RAPORT I SHKURTËR MBI PËRGGJIGJEN E ORGANEVE TË DREJTËSISË NDAJ VEPRAVE PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT

## GJETJET PRELIMINARE

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vlerëson qasjen, standardin dhe angazhimin e organeve të sigurisë dhe ndjekjes në hetimin dhe ndjekjen e veprave që ndërlidhen me krimet kundër të drejtave të votimit. Në të gjitha këto aspekte, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës kanë shënuar progres, gjithnjë duke krahasuar hetimin dhe ndjekjen e krimeve në zgjedhjet 2010 dhe zgjedhjeve të organizuara përpara kësaj date. Në këtë raport dhe vlerësimet që bëhen këtu përjashtohet veriu i Kosovës, ku kemi paqartësi sa i përket përgjegjësisë së organeve vendore dhe ndërkombëtare. Megjithatë, një gjë është e qartë se qytetarët si dhe kandidatët politik janë kërcënuar në vazhdimësi që nga fillimi i fushatës si dhe në ditën e votimit.

Nga gusht 2013 deri në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave me 3 nëntor 2013, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka monitoruar përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj ankesave të qytetarëve dhe zyrtarëve të caktuar rreth dyshimeve për veprat penale kundër të drejtave të votimit. Përveç monitorimit, IKD në vazhdimësi ka përkrahur Koordinatorin Nacional për zgjedhjet 2013 pranë Prokurorit të Shtetit në përgatitjet për të siguruar hetim dhe ndjekje efikase, përfshirë këtu thellimin e bashkëpunimit ndër-institucional, ngritjen e standardit të hetimeve, si dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të organeve të drejtësisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes sensibilizimit të publikut dhe shtrirjes së dorës për bashkëpunim të mirëfilltë.

Ky raport ka në fokus periudhën para ditës së zgjedhjeve dhe ditën e zgjedhjeve. Në vazhdim do të publikohen edhe raporte tjera të cilat do vlerësojnë në çdo hap veprimet e organeve të drejtësisë.

### Rekomandimet:

- Duhet avancuar edhe më tutje koordinimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit
- Gjatë zbatimit të PSV-ve, duhet shtuar kujdesin në respektimin e kornizës ligjore për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare
- Bazuar në përvojat dhe praktikën e ndërtuar të punës së Grupit Punues të Prokurorit të Shtetit për ditën e votimit me 3 nëntor 2013, metodologjia e punës së këtij grupi duhet avancuar për të

ardhmen, sidomos kur dihet se brenda një periudhe të shkurtër kohore do të nevojitet një mobilizim i ngjashëm për zgjedhjet e balotazhit, ku do të votohet në 24 komuna për kryetar të komunave. Prandaj, duhet theksuar se aspekti logjistik, kërkon një përkushtim më të madh për sigurimin e të gjitha kushteve të punës për të siguruar një efikasitet të Grupit Punues në kryerjen e detyrave.

- Duhet intensifikuar fushatën e PSH-së dhe PK-së që rastet të lajmërohen në kanale zyrtare, ku edhe do marrin përgjigje nga organet përkatëse
- Organet e ndjekjes duhet të avancojnë metodat e hetimit dhe të eliminojnë format e ndërlikuara të krimeve, që përfundimisht të eliminohen format e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta të kushtëzimit të votimit.

## BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Angazhimi i Kryeprokurorit të Shtetit për të thelluar bashkëpunimin ndër-institucional ka dhënë frytet në çdo hap të këtij procesi. Duke u bazuar gjithmonë në arsyeshmërinë se shumë më i vlefshëm është parandalimi sesa përbalja me pasojat, Kryeprokurori i Shtetit kishte ftuar organet sikurse Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, për të përpiluar dhe nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për zgjedhjet 2013.<sup>1</sup> Me këtë rast ishte caktuar Koordinatorja Nacionale e cila ka ndërmarrë hapa për të siguruar zbatimin e Memorandumit si dhe koordinimin e të gjithë akterëve. Në këtë Memorandum Bashkëpunimi ishte paraparë edhe krijimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) në mes të Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës, të cilat kishin saktësuar veprimet për hetim dhe ndjekje efikase të veprave që ndërliken me zgjedhjet, duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga e kaluara dhe përvojat më të mira bazuar në ligjet në fuqi. PSV-të kanë qenë trangu i bashkëpunimit efikas të paparë deri më tani sa i përket hetimit dhe ndjekjes së krimeve të caktuara. Zbatimi i PSV-ve kishte filluar qysh ditën e parë, ku çdo informatë që ka sugjeruar se po planifikohet manipulimi i procesit të zgjedhjeve është trajtuar me seriozitetin më të lartë.

Vlen të theksohet se kjo ka qenë një iniciativë e institucioneve vendore, që paraqet një hap mjaftë pozitiv në Kosovë, ku iniciativat për luftimin e krimeve të ndryshme më shumë shihen si rezultat i iniciativave dhe presioneve të komunitetit ndërkombëtarë. Për më tepër, Memorandumi i Bashkëpunimit përfundon vetëm atëherë kur edhe rastet zgjidhen me aktvendim të formës së prerë dhe ekzekutohen. Rrjedhimisht, deri në ato momente, të gjithë akterët duhet t'i trajtojnë këto raste me prioritet dhe do të njoftojnë publikun për të gjithë ecurinë.

## HETIME DHE NDJEKJE PROAKTIVE

Policia e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit kanë treguar përkushtim të lartë në zbatimin e PSV-ve gjatë kohës së fushatës elektorale, gjë e cila ka ndikuar pozitivisht në krijimin e klimës së qetë dhe me më pak presione gjatë fushatës dhe në ditën e votimit me 3 nëntor. Gjatë kohës së fushatës elektorale, nga 3 tetori deri më 31 tetor 2013, Policia e Kosovës ka regjistruar mbi 30 incidente, të cilat ndërliken me zgjedhjet. Nga këto raste, Prokurori i Shtetit ka filluar hetime penale për 16 raste, të cilat janë cilësuar si

<sup>1</sup> Memorandum Bashkëpunimi në mes KPK, KGJK, PK, KQZ, dhe PZAP lidhur me zgjedhjet 2013, 18 shtator 2013.

raste që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit rreth zgjedhjeve lokale. Shtatë Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës janë angazhuar në hapje të rasteve në komunat Prizren, Kamenicë, Klllokot, Prishtinë, Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Malishevë, Suharekë, Lipjan, Graçanicë dhe Junik. Veprat penale karakteristike kundër të drejtave të votimit për të cilat janë hapur hetime penale gjatë kohës së fushatës kanë të bëjnë me kanosjen, cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve, si dhe dhënien dhe marrjen e rryshfetit në lidhje me votimin. Prokurori i Shtetit ka bërë kërkesa pranë Gjykatave kompetente për caktimin e një sërë masash ndaj personave të pandehur për këto raste, ku gjykatat kanë shqiptuar masa, të paraqitjes në stacion policor, arrestit shtëpiak dhe masën e paraburgimit.

IKD ka monitoruar veprimet e policisë dhe prokurorëve në disa raste që janë paraqitur apo iniciuar gjatë kohës së fushatës. IKD vlerëson se këto institucione kanë vepruar në harmoni në mes vete dhe në përputhje me PSV-të. IKD vlerëson lartë gatishmërinë dhe rolin shumë proaktiv të këtyre institucioneve në këtë kohë fushate, në të gjitha rastet e paraqitura në lidhje me zgjedhjet gjatë kësaj kohe të fushatës.

Gatishmëria e Prokurorit të Shtetit për të trajtuar në kohë sa më të shpejtë secilin rast ka bërë që kandidatët e partive politike dhe qytetarët tjerë të jenë më të përgjegjshëm në deklaratat e tyre publike. Në këtë mënyrë janë evituar shpërndarja e informatave të pasakta dhe thashethemeve të pabazuara për manipulim të votës, të cilat shpeshherë kanë krijuar vetëm spektakle mediale por nuk janë zgjidhur në rrugën ligjore.

Veprat penale që ndërlidhen me zgjedhjet janë mjaftë të ndërlikuara dhe se format e ndryshme që ekzistojnë në Kosovë krijojnë hapësirë për manipulime që paraqesin sfidë të madhe për organet e drejtësisë. Ndërlidhja e punësimit në administratën publike dhe përkrahja për partinë e caktuar politike është vetëm një nga krimet të cilat është vështirë të zbulohet duke pasur parasysh se premtimet dhe planifikimet bëhen në katër sy dhe në mes personave që kanë nivel të lartë të besimit në mes vete. Po ashtu, sfidë ende mbeten disa aspekte të cilat mund të jetë edhe herët të vlerësohen sikurse që është hetimi i financimit të aktiviteteve të partive politike.

Sa i përket kornizës ligjore, Kodi Penal si dhe dokumentet tjera sikurse Procedurat Standarde të Veprimit kanë saktësuar më mirë veprat penale si dhe procedurat për ndjekje më efikase të veprave kundër të drejtave të votimit.

## BASHKËPUNIMI ME QYTETARËT

Organet e drejtësisë kanë treguar përkushtim të madh për të vendosur marrëdhënie të veçantë me publikun, duke u angazhuar në një fushatë sensibilizuese gjithëpërfshirëse që nga fillimi i fushatës elektorale. Përveç hartimit dhe miratimit të PSV-ve, të cilat e mundësojnë një qasje dhe standard tepër profesional të organeve të ndjekjes, Koordinatorja Nacionale ka organizuar trajnime për prokurorët, është angazhuar në sensibilizimin e opinionit duke bashkë-organizuar me IKD-në shtatë debate në qendrat kryesore të vendit së bashku me përfaqësuesit e Prokurorive Themelore në qendrat përkatëse si dhe përfaqësuesit e policisë, gjyqësorit, KQZ-së, PZAP-it, partive politike, shoqërisë civile dhe mediave. Shoqëria civile ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe sidomos komisionerëve të partive politike sa i përket ndryshimeve në Kodin Penal si dhe angazhimin e institucioneve shtetërore për të hetuar dhe ndjekur rastet e manipulimit të zgjedhjeve.

Të gjitha përmbledhjet 10 minuta Speciale të debateve në shtatë qendrat kryesore të Kosovës janë transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës në prime-time. Për më tepër, përfaqësues të organeve të drejtësisë kanë bërë paraqitje të shumta mediale dhe prononcime për media të cilat gjithsesi se kanë sensibilizuar opinionin rreth gatishmërisë së organeve të ndjekjes si dhe rrezikshmërisë së përfshirjes në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit.

Gjatë këtij procesi zgjedhor, çështja e numrit telefonik ku duhet të raportohen rastet është mjegulluar paksa. Përveç numrit zyrtar të telefonit të policisë, organizatat e shoqërisë civile kanë hapur edhe një linjë telefonike ku kanë ftuar qytetarët të raportojnë rastet përmes një mesazhi në telefon. Në këtë linjë telefonike kanë arritur mbi 6,000 mesazhe të cilat janë cilësuar si raportim i parregullsisë.<sup>2</sup> Mungesa e koordinimit me organet e drejtësisë ka bërë që këto raportime të përfundojnë vetëm si statistika dhe për këto raste të mos ketë ndjekje. Përfundimisht, qytetarët kanë marrë informata të ndryshme që edhe kanë shkaktuar huti.

Kryetarja e KQZ-së, thotë se shumë komisioner janë tërhequr dhe është dashur të zëvendësohen para ditës së zgjedhjeve, pjesërisht për shkak se kanë kuptuar seriozitetin e organeve të drejtësisë për të ndjekur të gjithë shkelësit e ligjit.<sup>3</sup> Bashkëpunimi i ngushtë ka bërë që në ditën e zgjedhjeve qytetarët të mos hezitojnë të raportojnë për shumë raste tek organet e ndjekjes. Rrjedhimisht niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e ndjekjes është rritur në nivel të kënaqshëm.

## REAGIMET E SHPEJTA

Në ditën e zgjedhjeve, organet e ndjekjes kanë caktuar 50 prokurorë kujdestarë, të cilët kanë qenë në shërbim nga mëngjesi deri në përfundim të numërimit të votave dhe bartjes së kutive në Qendrën për Numërim të Rezultateve. Përveç Koordinatorës Nacionale, Kryeprokurori i Shtetit ka mbikëqyrur gjatë tërë kohës koordinimin dhe angazhimin e prokurorëve. Njëkohësisht, Policia e Kosovës ka angazhuar 5,533 polic kujdestarë dhe po ashtu ka angazhuar hetues.

Koordinatorja Nacionale për zgjedhje nga Prokurori i Shtetit ka caktuar Grupin Punues për Ditën e Votimit me 3 nëntor, në përbërje të Koordinatorës Nacionale, tetë zyrtarëve të Sekretariatit të KPK-së, si dhe monitoruesit nga IKD. Ky grup është vendosur në zyrat e Prokurorit të Shtetit në Prishtinë dhe ka koordinuar punën e 50 prokurorëve në komunat përkatëse.

Institucionet e drejtësisë, në këtë rast të sigurisë dhe ndjekjes kanë harmonizuar veprimet ngushtë dhe kanë reaguuar në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit. Zbatimi i këtyre procedurave ka mundësuar një efikasitet të shtuar të veprimeve të policisë dhe prokurorëve në teren, duke zbatuar parimin kryesor të ndalimit dhe arrestimit të personave që përfshihen në çfarëdo mënyrë në keqpërdorimin e zgjedhjeve. Prokurorët kanë zhvilluar hetime dhe ndjekje proaktive dhe reagimet kanë qenë të menjëhershme për çdo informatë që kanë pranuar. Për të iniciuar rastet, prokurorët kanë shfrytëzuar disa burime të informacionit, duke përfshirë këtu komisionerë, vëzhguesit, raportimet e televizioneve, portaleve informative, madje edhe rrjetet sociale, siç është Facebook.

<sup>2</sup> Mbi 6000 votues raportuan parregullsitë në kuadër të kampanjës “Voto dhe vëzhgo”, shih <http://kfos.org/more-than-6000-voters-reported-irregularities-during-campaign-vote-ëatch/>.

<sup>3</sup> Intervistë e Znj. Valdete Daka, Kryetare e KQZ-së, në emisionin e mëngjesit në Radio Televizionin e Kosovës 1, 1 nëntor 2013.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, janë iniciuar 21 raste me 35 persona. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të drejtësisë mbetet një çështje që kërkon kujdes të veçantë për tu trajtuar, duke pasur parasysh se është një vijë e hollë që ndan veprimet e caktuara penale nga ushtrimi i të drejtave individuale.

Të gjitha informatat janë sistemuar në bazën e të dhënave në formë elektronike dhe është përcjellur se si kanë rrjedhur hetimet rreth rastit, sa persona janë përfshirë, si dhe masat e ndërmarra. Baza e të dhënave me vetëm me shifra rreth rasteve nuk ka plotësuar më së miri nevojat. Andaj, është e nevojshme që të bëhet edhe përshtetimi pak më i detajuar ku do të përfshiheshin emrat e personave të përfshirë në rast si dhe veprimet e detajuara ligjore të rastit. Një bazë e të dhënave më e avancuar do të shërbente për informim më të mirë të prokurorëve dhe policëve që koordinojnë punët e këtyre organeve gjatë ditës së zgjedhjeve dhe njëkohësisht do të evitonte çdo keqkuptim në opinion publik rreth interpretimit të rasteve. Kushtet e punës dhe resurset njerëzore kanë qenë jo-adekuate për volumin e informatave dhe nevojave reale për të monitoruar me sukses mediat dhe informatat të merren në kohë reale sa i përket raportimit për raste të manipulimit.

Praktika e sistemimit të të dhënave rreth veprimeve të policisë dhe prokurorisë për të informuar opinionin publik gjatë fushatës zgjedhore ka vazhduar me dinamikën e nevojshme edhe në ditën e votimit. IKD vlerëson lartë qasjen e Prokurorit të Shtetit në lidhje me mediat dhe opinionin publik. Gjatë ditës së votimit ashtu siç ishin paralajmëruar mediat, janë mbajtur pesë konferenca të rregullta nga Koordinatorja Nacionale për zgjedhje, pra një konferencë më shumë sesa ishin paralajmëruar. Pas mbajtjes së të gjitha konferencave, Prokurori i Shtetit ne uebfaqen zyrtare ka bërë menjëherë publikimin e komunikatës për media, në të cilën janë plasuar informacionet e fundit rreth aktiviteteve të institucioneve të drejtësisë në lidhje me zgjedhjet.

## VLERËSIMET PRELIMINARE

Vlerësimet nga vëzhguesit vendor dhe ndërkombëtarë kanë qenë pozitive, duke përjashtuar këtu vlerësimet për veriun, ku theksohet se është cenuar e drejta për të votuar.

Misioni ndërkombëtar i ENEMO-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, sa i përket procesi zgjedhor ka theksuar:

“Raundi i parë i zgjedhjeve në Republikën e Kosovës është administruar në mënyrë efikase në atmosferë të qetë, por mbetet sfida e pasaktësive të listës së votuesve dhe pamundësimi i një numri të votuesve nga ushtrimi i lirë i të drejtës së tyre për votim në komunat në veriun e Kosovës, për arsye të sigurisë.”

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve ka theksuar:

“Në pjesën më të madhe të Kosovës, ambienti i zgjedhjeve ishte i qetë dhe garuesit ishin në gjendje të zhvillonin fushatën lirshëm. Pretendimet se në disa rajone është ushtruar presion mbi punonjësit e shërbimit publik, përfshirë këtu edhe mësimdhënësit, për të marrë pjesë në manifestimet e fushatës u vlerësuan nga BE MVZ si të besueshme. Task Forca e udhëhequr nga Kryeprokurori ka ngritur disa raste të veprave që kanë të bëjnë me fushatën, sipas kodit penal, përfshirë këtu frikësimin dhe ofrimin e rryshfetit. Frikësimi dhe presioni i atyre që ishin kundër zgjedhjeve kundër aktivistëve politikë dhe votuesve në katër komunat veriore kanë kufizuar aktivitetet e fushatës për garuesit, duke krijuar një ambient të pafavorshëm për fushatë të lirë.”

Rrjeti i organizatave jo-qeveritare Demokracia në Veprim ka vlerësuar:

“Procesi i përgjithshëm i zgjedhjeve lokale të 3 nëntorit 2013, ka qenë një proces i qetë, i rregullt dhe demokratik, me përjashtim të veriut të vendit ku kishte parregullsi ku, sipas tyre, Institucionet përgjegjëse për sigurinë në atë pjesë të vendit nuk kanë arritur të ofrojnë sigurinë e duhur për procesin e votës së lirë dhe demokratike.”

Njëkohësisht, përfaqësuesit e misionëve diplomatike të vendeve të ndryshme në Prishtinë si dhe Bashkimit Evropian kanë vlerësuar se Kosova është e aftë të mbajë zgjedhje të lira dhe fer, dhe se qytetarët duke raportuar raste tek organet e drejtësisë kanë treguar përkushtimin e tyre për zgjedhje të lira dhe transparente si dhe besimin tek organet e ndjekjes.

## RRETH PROJEKTIT ([www.kli-ks.org/zgjedhjet/](http://www.kli-ks.org/zgjedhjet/))

Instituti i Kosovës për Drejtësi, po zbaton projektin “Iniciativa për ngritje të efikasitetit të organeve të drejtësisë për proces zgjedhor të lirë, drejtë dhe demokratik”, i cili ka për qëllim që të forcojë kapacitetet dhe risë bashkëpunimin me organet e drejtësisë në luftimin e efektiv të çfarëdo lloj krimi që pengon procesin e lirë, të drejtë dhe të besueshëm zgjedhor në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Ky projekt udhëhiqet nga bashkë-autorët raporteve analitike të vetme vendore të cilat kanë trajtuar përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj krimeve të zgjedhjeve. IKD gjatë këtij projekti do të mbështes organet e ndjekjes në trajnim dhe ofrim të këshillave rreth ndjekjes efikase të krimeve të zgjedhjeve, sensibilizimin e opinionit rreth krimeve të zgjedhjeve, mbikëqyrjen e përgjigjes së organeve të drejtësisë sa i përket krimeve të zgjedhjeve, si dhe përpilimin e raporteve të cilat japin rekomandime konkrete për të përmirësuar funksionimin e organeve të drejtësisë në të ardhmen.

Qëndrimet e shprehura në raport janë të autorëve, ato nuk janë domosdoshmërisht qëndrime të donatorit.

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD  
Rr. Rexhep Luci  
9 A / hyrja 1 / nr. 5  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina